
Monedha	leke	Çmimi	1000(njemije)
---------	------	-------	---------------

Dokumentet standarde te ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit te fituesit;
- Formulari i publikimit te njoftimit te fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit te Vlerësimit te Ofertave.

13.Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me poste ose dorazi, ne vendin e përcaktuar ne dokumentet e ankandit.

BASHKIA SELENICË
NJOFTIM I ANKANDIT

1. Autoriteti i dhënies në përdorim : Bashkia Selenicë, me adresë rruga “Llambi Bombaj”, pranë spitalit Selenicë , e-mail:bashkia.selenicë@gmail.com , fton konkuruesit kandidatët/ofruesit të marrin pjesë në ankandin e hapur me Nr.REF.2 –A /2023
2. Data e Zhvillimit të Ankandit : 10.05.2023
3. Lloji i Procedurës standarte të Ankandit : Procedurë e hapur .
4. Objekti : “Objekti i përdorimit është dhënia në përdorim të përkohshëm të sipërfaqes kullosore “Për qëllime pushimi,argëtimi,shëndetsore,shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash,mjedise sportive,shplodhëse,kulturore, etj. sipas udhëzimit nr.1,datë 09.06.2016” Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe kullosor Publik”
5. Sipërfaqja e fondit kullosor 4.89 ha të ndarë në lote sipas tabelës :

Tabela me të dhënat përkatëse dhe lloji i veprimtarisë për dhënie me qira përdorimi

Nr. Lotit	Bashkia	Kodi kadastral	Ekonomia kullimore	Nr.Ng & Nr.kadastral	Kateg. Përdor.	Sip. ha	Lloji veprimt.	Çmimi lek/ha 6-10vjet	Shuma lekë
1	Selenicë	1265	Gjorm-Vranisht	18	Inproduktiv e	0.93	Veprimtari turistike	82500	76725
2	Selenicë	1265	Gjorm-Vranisht	16	Inproduktiv e	2	Veprimtari turistike	49500	99000
3	Selenicë	3308	Kotë-Sevaster	62	Bimësi pyjore	1	Veprimtari turistike	49500	49500
4	Selenicë	1265	Gjorm-Vranisht	16(542/1/1)	Kullotë	0.14	Veprimtari turistike	82500	11550
5	Selenicë	2953		116	PF	0.22	Magazine bujqesore	27272	6000
Shuma						4.89			

6- Afati i dhënies në përdorim është 10 (dhjetë) vjet duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës .

7- Vlera financiare dysheme mbështetet në VKM , nr. 559 , datë 29.7.2022 “ Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore ” për detyrimin e përdorimit .

8-Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrjen: datë 10 .05.2023 ora 09:00

9-Vendi i Zhvillimit të Ankandit : Adresa Bashkia Selenicë

10 .Vlerësimi i ofertave konkurruese do të bëhet me pikë si vijon:

- projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10 000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit 20 pikë;
- planbiznesi dhe investimet që do të bëhen 15 pikë;
- planin e rehabilitimit të sipërfaqes 25 pikë;
- nivelin e punësimit në veprimtari 5 pikë;
- masën e qirasë për ha/vit 35 pikë

11. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurim janë:

- a) formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar, për secilin lot më vete, në dokumentet standarde të konkurimit.
- b) ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë.
- c) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.

d) në rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e të cilit depozitohet pranë komisionit të vlerësimit të ofertave.

e) vërtetim nga prokuroria, Gjykata, Drejtoria Rajonale Tatimore, Taksat Vendore.

12 . Dokumentacioni i nevojshëm:

- a. Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të pasurisë shtetërore, së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- b. Ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- c. Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- d. Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- e. Të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- f. Planin e rehabilitimit të sipërfaqes nëse është i zbatueshem;
- g. Nivelin e punësimit në veprimtari;
- h. Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- i. Adresën e subjektit, telefon, e-mail .

13. Dokumentacioni duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkuresi me mbishkrimin “Ofertë për dhënie në përdorim”, dhe i dorëzohet komisionit të posaçëm për vlerësimin e dokumentacionit, në orën e hapjes së procedurës së konkurimit. Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme ose paraqitja e dokumentave të rremë, përbën kusht skualifikues. Ofertat dorëzohen nga konkurenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.

14- Informacion mbi dokumentat e Ankandit: Dokumenta të Ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit të Bashkisë Selenicë , Qarku Vlorë .

Dokumenta me pagesë: Po x Jo

Nëse po,

Monedha në Lekë Çmimi _1000_

15- Dokumentat standarte të Ankandit përbëhen nga:

- Formulari i njoftimit,
- Kërkesa për pjesëmarrje,
- Formulari i ofertës,
- Ftesa për ofertë,
- Formulari i njoftimit të fituesit,
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit.